



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS
KËSHILLI DREJTUES

Nr. 330 / 3 prot.

Tiranë, më 25.3.2024

V E N D I M

Nr. 8, datë 25.3.2024

PËR
DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 25, DATË 23.10.2017, "PËR NORMIMIN DHE
SHPËRBLIMIN E VEPRIMTARISË AKADEMIKE,
NË ZBATIM TË PROGRAMIT TË FORMIMIT FILLESTAR DHE VAZHDUES,
NË SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS"

Në mbështetje të nenit 118 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 243 dhe 248 të ligjit nr.115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë"; të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"; të ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë"; të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve të Republikës së Shqipërisë"; të nenit 124 të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar; si dhe të ligjit nr.84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023"; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 748, datë 11.6.2009, "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë", (i ndryshuar), me propozim të Drejtorit të Shkollës së Magjistraturës, Këshilli Drejtues, i mbledhur më datë 25.3.2024,

V E N D O S I:

1. Lidhja nr.1 "Konvertimi i elementeve për përgatitjen dhe mbështetjen e procesit të formimit profesional në kuadrin e Formimit Fillestar dhe Vazhdues, pika 1 dhe 2 ndryshon si vijon:

1.	Hartimi i tezave të provimit të pranimit për fazën e parë (scan tron).	4000 (katër mijë) lekë/tezë (10 pyetje/fushë)
2.	Hartimi i tezave të provimit të pranimit për fazën e dytë (testi profesional).	7000 (shtatë mijë) lekë/tezë

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.